



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim B-A

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 15 leksione / 45 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore B-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe refleksat redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre. Në përfundim të kursit studentët do të jenë i aftë:

1. të përvetësojë dhe të zgjerojë fjalorin.
2. Të përmirësojë aftësitë gramatikore dhe stilistikore në të dyja gjuhët (A dhe B)
3. Të zhvillojë kompetencën kulturore dhe ndërkulturore
4. të përmirësojë përqendrimin
5. Të realizojë përkthimet e veta në mënyrë të pavarur

Rezultatet të pritshme:

Ky kurs do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmblendhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.